



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:014808  
Datë: 26.06.2024  
Numri i dokumentit: 05861858

Pml.nr.326/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit S. G., nga P., për shkak të veprës penale “Ndërtimi pa leje” e parashikuar me nenin 359, paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.82/2021, të datës 28.04.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1015/2023, të datës 18.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 06.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S. G., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.82/2021, të datës 28.04.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1015/2023, të datës 18.12.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.82/2021, të datës 28.04.2023, i dënuari S. G. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Ndërtimi pa leje” e parashikuar me nenin 359, paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së dhe ndaj

të njëjtit është shqiptuar dënim me kusht, ashtu që është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i dënuari nuk kryen veprë penale tjetër brenda periudhës verifikuese prej katër (4) vjetëve, e cila periudhë kohore do të llogaritet nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Është vendosur që të rrënohet objekti i ndërtuar pa leje, i përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa shpenzimet e rrënimit do t'i bartë i dënuari. Është detyruar i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzet (20) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të kimit të paguajë shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e PA1.nr.1015/2023, e datës 18.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit S. G., avokati Gëzim Kollçaku, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.183/2024, e datës 28.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S.G., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit S. G., në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në përgjithësi e konteston pranimin e fajësisë nga ana e të dënuarit dhe miratimin e një pranimi të tillë nga ana e gjykatës, duke theksuar se i njëjti i kishte sugjeruar të dënuarit që mos ta pranonte fajësinë, me arsyetimin se veprimet e të dënuarit nuk përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën ishte akuzuar, pasi që në vendin ku është kryer ndërtimi nuk kërkohet leja e ndërtimit, e që nga kjo rezulton se kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit.

Gjithashtu, pretendon se në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të detajuar kishte argumentuar se në këtë rast janë bërë shkelje të ligjit penale në dëm të të dënuarit, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës, duke i injoruar të gjitha këto argumente, pa dhënë asnjë arsyetim e kishte refuzuar ankesën e paraqitur dhe e kishte vërtetuar aktgjykimin e kundërshtuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës konstatoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të ndikonin në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e tyre, si dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit S. G.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj rezulton se ka paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha çështjet e rëndësishme, përkatësisht për të gjitha pikat e aktgjykimit, duke përfshirë këtu edhe paraqitjen e arsyeve sa i përket vendimit për miratimin e pranimi të fajësisë, ku me atë rast kishte vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë të parashikuara në nenin 242 të KPP-së.

Ndërsa, nga procesverbali i shqyrtimit fillestar të datës 19.04.2023, shihet se pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i dënuari S. G., e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ishte akuzuar, ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të mbrojtësit të të dënuarit dhe prokurorit të shtetit, kishte marr aktvendimin me të cilin e kishte miratuar pranimin e fajësisë, duke konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për një gjë të tillë, konform nenit 242, paragrafi 2 të KPP-së, ndërsa ndaj një aktvendimi të tillë, palët dhe mbrojtësi nuk kanë pasur ndonjë vërejtje. Përtej kësaj, nga procesverbali i lartcekur, shihet se edhe vetë mbrojtësi i të dënuarit, avokati G. K., kishte propozuar që pranimi i fajësisë të aprovohet nga gjykata (faqe 2, pasuesi i parafundit i Procesverbalit të lartcekur), duke shtuar se i dënuari i ka kuptuar të gjitha privilegjet dhe kufizimet që dalin nga pranimi i fajësisë dhe me vullnet të plotë e ka bërë një gjë të tillë, pas konsultimeve me mbrojtësin.

Në këtë drejtim, pas shikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se në këtë rast janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore që i referohen pranimi të fajësisë në kuptim të neneve 241 – 242 të KPP-së, pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për miratimin e pranimi të fajësisë, siç me të drejtë ka vepruar edhe gjykata e shkallës së parë, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes nuk qëndrojnë.

Siç është theksuar edhe më lart, i dënuari S. G., ishte akuzuar dhe shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Ndërtimi pa leje” e parashikuar në nenin 359, paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstaton se në këtë rast nuk është shkelur as ligji penal në dëm të të dënuarit S. G., siç pretendon mbrojtja, pasi që veprimet e tij të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i përbëjnë të gjitha tiparet e figurës së veprës penale për të cilën ishte akuzuar dhe shpallur fajtor, ndërsa në anën tjetër, nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme e cila do ta pengonte ndjekjen penale apo do ta përjashtonte përgjegjësinë penale të të dënuarit, në lidhje me veprën penale të lartcekur.

Në këtë aspekt, duke u bazuar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe në shkresat tjera të lëndës shihet që i dënuari S. G., pas muajit Prill të vitit 2019 e në vazhdimësi deri më

datën 24.11.2020, në Bjeshkët e Lumëbardhit, komuna e Pejës, Zonë e Mbrojtur – Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, si pronar, kishte ndërtuar objekt pa leje për të cilën kërkohet leja e tillë në bazë të Ligjit për Ndërtim dhe atë neneve 7 dhe 14, në atë mënyrë që i dënuari në vendin e lartcekur edhe pse nuk kishte marrë leje ndërtimore, fillon ndërtimin e një vile dhe në ndërtim e sipër hetohet nga Policia e Kosovës dhe zyrtarët e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, të cilët e bëjnë ndalimin e punës. Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart, rezultoi që i dënuari S. G., në cilësinë e pronarit, kishte filluar që ta ndërton një objekt - vilë, në vendin e theksuar më lart, pa poseduar leje për ndërtim, edhe pse një gjë e tillë kërkohet sipas Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtimin, i datës 31.12.2012, përkatësisht sipas neneve 7 dhe 14 të këtij Ligji. Është e rëndësishme që të theksohet se në nenin 7 të Ligjit për Ndërtimin është parashikuar se “Pjesëmarrësit në ndërtim janë aplikuesi, poseduesi i lejes ndërtimore, projektuesi, kontraktuesi”, kurse në nenin 14 të këtij Ligji janë parashikuar llojet për të cilat lëshohet leja ndërtimore, sipas së cilët dispozitë ligjore “Leja ndërtimore kërkohet për aktivitetet vijuese: 1.1. ndërtimi i ri (përfshirë montazhet); 1.2. rindërtimi i objekteve ekzistuese; 1.3. rrënimi i objekteve ekzistuese; 1.4. riparimi i objektit ndërtimor, nëse ndodh ndryshim thelbësor i tij krahasuar me situatën para paraqitjes së dëmit nga katastrofat natyrore, luftërat apo ngjarjet e ngjashme dhe 1.5. intervenimet në fasadat dhe strukturën (sanimet) e një objekti ekzistues”.

Në anën tjetër, për dallim nga kodet penale të mëparshme, tani me dispozitat ligjore të KPRK-së, “Ndërtimi pa leje” është parashikuar në mënyrë shprehimore edhe si vepër penale. Kështu, në nenin 359, paragrafi 2 të KPRK-së është parashikuar se veprën penale “Ndërtimi pa leje” e kryen “Personi i cili është pronar, investitor apo personi përgjegjës i subjektit juridik i cili është investitor në objektin në ndërtim pa leje ndërtimi, kur me ligj kërkohet një leje e tillë”, ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, e cila kryhet “Nëse vepra nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet në pronë publike apo shtetërore, në pronën e tjetrit, në zonat e mbrojtura, zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura, zonat me interes të veçantë ekonomik, zonat sanitare për përdorimin e ujit ose zonat e mbrojtur për qëllime strategjike”.

Kurse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” i datës 13.12.2012 dhe në dispozita tjera përkatëse është parashikuar se Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, konsiderohet “Zonë e Mbrojtur”, ndërsa pikërisht në hapësirën e këtij Parku, i dënuari S. G., si pronar, kishte filluar që ta ndërtonte një objekt – vilë, duke mos poseduar leje të ndërtimit, gjë për të cilën edhe e kishte pranuar fajësinë, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, andaj edhe në këtë aspekt, siç është theksuar edhe më lart, veprimet e të dënuarit i përbëjnë të gjitha tiparet e veprës penale për të cilën ishte akuzuar dhe shpallur fajtor.

Në anën tjetër, në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë shihet se janë vlerësuar pretendimet thelbësore ankimore të ngritura në ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket këtyre pretendimeve, kështu që edhe në këtë drejtim, pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë rezultojnë të pabazuara.

Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.326/2024, më datë 06.06.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj